



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria-Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit  
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije  
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

# UDHËZUES PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE GJATË MËSIMIT NË DISTANCË

Prill 2020





# UDHËZUES PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE GJATË MËSIMIT NË DISTANCË

Prill 2020

## Udhëzues për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimin në distancë

Prill 2020

Prishtinë

### **Për hartimin e këtij Udhëzuesi kontribuan:**

Nikoleta Mita, Dukagjin Pupovci, Eda Vula, Selim Mehmeti, Ismet Potera, Osman Buleshkaj, Lulavere Kadriu, Labëri Luzha, Naser Zabeli, Mirlinda Dehari-Zeka, Ermal Lubishtani, Xhavit Rexhaj, Besa Luzha, Besim Mustafa, Gëzim Berisha, Blerim Saqipi, Afrone Lila, Diana Qarkaxhija.

Design: **envinion**

# Përmbajtja

<b>LISTA E SHKURTESAVE .....</b>	<b>6</b>
<b>1. HYRJE .....</b>	<b>7</b>
<b>2. PARIMET E VLERËSIMIT NË MËSIMIN NË DISTANCË .....</b>	<b>9</b>
<b>3. METODA DHE REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME PËR VLERËSIM .....</b>	<b>11</b>
3.1. Vlerësimi i nxënësve sipas kërkesave kurrikulare dhe modaliteti i vlerësimit në distancë .....	12
3.2. Vlerësimi gjatë pandemisë COVID-19 .....	12
3.2.1. Vlerësimi formues gjatë mësimit në distancë.....	13
3.2.2. Vlerësimi përfundimtar gjatë mësimit në distancë .....	13
3.3. Metodatat e vlerësimit gjatë mësimit në distancë.....	15
3.3.1 Metodatat standarde.....	15
3.3.2. Metodatat inovatore (kreative dhe ndërvepruese) .....	17
3.4. Menaxhimi i vlerësimit.....	19
<b>4. MODALITETET E VLERËSIMIT NË RASTE SPECIFIKE .....</b>	<b>21</b>
4.1. Vlerësimi në nivelin parafillor.....	21
4.2. Vlerësimi në arsimin fillor .....	22
4.3. Vlerësimi në arsimin e mesëm të ulët .....	23
4.4. Vlerësimi në arsimin e mesëm të lartë.....	25
4.4.1. Vlerësimi në arsimin profesional .....	25
4.5. Vlerësimi në lëndët artistike.....	26
4.6. Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta .....	26
<b>5. ROLI I PRINDËRVE .....</b>	<b>28</b>

# Lista e shkurtesave

<b>DKA</b>	Drejtoria Komunale e Arsimit
<b>MASHTI</b>	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
<b>PIA</b>	Plani Individual i Arsimit
<b>RNK</b>	Rezultatet e të Nxënit për Kompetenca
<b>RNL</b>	Rezultatet e të Nxënit për Lëndë Mësimore
<b>RTK</b>	Radio Televizioni i Kosovës
<b>TIK</b>	Teknologjia e Informacionit dhe e Komunikimit
<b>VP</b>	Vlerësime Përmbledhëse

# 1. Hyrje

Në Kosovë, në kushte të imponuara të pandemisë COVID-19, nga data 12 mars 2020, në bazë të udhëzimeve të Qeverisë së Republikës së Kosovës është ndërprerë mësimi nëpër shkolla dhe institucione të arsimit të lartë dhe ka filluar të realizohet mësimi në distancë. Në përputhje me ligjet në fuqi, Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ka koordinuar përpjekjet për organizimin e mësimit në arsimin parauniversitar, ndërsa institucionet e arsimit të lartë kanë organizuar studimet në mënyrë të pavarur. Ky udhëzues i referohet në mënyrë specifike vlerësimit të nxënësve në arsimin parauniversitar.

Në fakt, mësimi në distancë në Kosovë në kushtet e pandemisë, si edhe në shumicën e vendeve të rajonit, ka filluar pa përgatitjet e duhura që do të duhej ta shoqëronin një sipërmarrje të tillë. Prandaj edhe duhet pranuar se mësimi në distancë në Kosovë ballafaqohet me të panjohura, të cilat duhet të adresohen me kohë dhe duke ju përshtatur kontekstit.

Mësimi në distancë për klasat 1-9 po realizohet nëpërmjet transmetimit të mësimeve të regjistruara në televizionin publik (RTK), si dhe përmes kanalit të MASHTI në Youtube. Ndërsa në nivel të shkollave të mesme të larta mësimi në distancë zhvillohet në mënyrë të decentralizuar – në nivel shkolle, ku mësimdhënësit janë bartësit kryesor të mësimit në distancë. Po ashtu, janë hartuar udhëzime për mobilizimin e shkollave që t'u përshtaten kushteve të reja të punës, si dhe janë inkurajuar nisma të shkollave dhe të drejtorive komunale të arsimit për zbatimin e formave të tjera të mësimit në distancë, përfshirë organizimin e sesioneve online në kohë reale, përgatitjen e materialeve elektronike për mësim, kontrollimin e detyrave të nxënësve, dhënien e informatës kthyesë, komunikimin me familjen, etj. Sipas raporteve të drejtorive komunale të arsimit, numri i mësimdhënësve dhe shkollave të përfshira në mësimin që po gjejnë forma për të zhvilluar aktivitete online me nxënësit e tyre po rritet nga dita në ditë, gjë që ka ndikim pozitiv në motivimin e fëmijëve që të mësojnë dhe përballojnë më lehtë situatën në të cilën ndodhemi.

Një nga çështjet e rëndësishme që bashkëshoqëron mësimin në distancë është vlerësimi i nxënësve. Një sërë pyetjesh, që lidhen me parimet e vlerësimit të mësimit në distancë, me llojet e vlerësimit në distancë, me kërkesat për përbushjen e standardeve dhe me shmangien e pabarazisë për shkak të pamundësisë për të përdorur teknologjinë dhe të shkallës së aftësisë digjitale të nxënësve dhe mësimdhënësve, kërkojnë përgjigje dhe zgjidhje.

Qëllimi i këtij dokumenti është të ofrojë udhëzime për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë në kushtet e pandemisë COVID-19, në mënyrë që të mbështetet përfundimi i vitit shkollor 2019/20 dhe të evidentohen arritjet individuale të nxënësve. Me rastin e hartimit të Udhëzuesit, MASHTI ka parasysh gjithë kompleksitetin e situatës së tanishme në Kosovë, e cila nuk dallon shumë nga vendet e tjera të rajonit, si dhe diversitetin e konteksteve në të cilat zhvillohet mësimi në distancë. Për këtë arsye, Udhëzuesi nuk ofron zgjidhje të gatshme për vlerësimin e nxënësve në kushtet e tanishme, por paraqet udhërrëfyes dhe ide për veprim, të cilat shkollat dhe mësimdhënësit duhet t'i zbatojnë duke iu përshtatur kontekstit dhe rrethanave.

Ky Udhëzues nuk ofron zgjidhje të gatshme për vlerësimin e nxënësve, por udhërrëfyes dhe ide për veprim që duhet zbatuar duke iu përshtatur kontekstit dhe rrethanave.

## **UDHËZUES PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE GJATË MËSIMIT NË DISTANCË**

Në momentin e hartimit të këtij Udhëzuesi nuk mund të parashikohet rrjedha e mëtutjeshme e pandemisë, përfshirë kohëzgjatjen e masave për kufizimin e lëvizjes, komunikimit dhe grumbullimit. Prandaj, udhëzuesi është hartuar me supozimin se mësimi në distancë do të zbatohet deri në përfundim të vitit shkollor 2019/20, ndërsa gjatë muajve të verës mund të organizohet ndonjë formë e mësimit plotësues për fëmijët të cilët nuk kanë qenë në gjendje ta përcjellin mësimin në distancë.



## 2. Parimet e vlerësimit në mësimin në distancë

Në kontekstin aktual, kur misioni i shkollimit realizohet nëpërmjet mësimin në distancë, duhet kuptuar se mësimi në distancë nuk është thjesht çështje e bartjes së mësimin tradicional ballë për ballë në formë të mësimin online. Në momentin e tanishëm duhet të zhvillojmë një qasje të mësimdhënies e cila, paralelisht me ofrimin e përvojave sa më atraktive të të nxënës, edhe i përkrahë fëmijët e familjet në përballje me rrezikun e pandemisë. Autoritetet arsimore, ekspertët dhe mësimdhënësit duhet të identifikojnë pikën e balancit në mes të kërkesave kurrikulare respektivisht arritjes së nivelit të domosdoshëm të rezultateve të pritshme të të nxënës, dhe gjendjes së krijuar, por njëkohësisht kërkohet edhe të udhëzojnë se si do të realizohet vlerësimi si një pjesë integrale e procesit mësimor.

Si parim udhëheqës, theksojmë se “...krahas me përvetësimin e rezultateve të të nxënës nëpërmjet përmbajtjeve bërthamë, theksi duhet vendosur në mirëqenien e fëmijëve e në nxitjen e të nxënës, dhe jo në vlerësimin e përmbajtjes së mësuar”.<sup>1</sup>

Së këndejmi, në këtë dokument i referohemi plotësisht të kërkesave thelbësore në kushte të reja, përkatësisht realizimit të përmbajtjeve të zgjedhura të lëndëve mësimore, si dhe një qasjeje të kufizuar të arritjes së rezultateve mësimore gjatë vlerësimit.

Ne besojmë se zbatimi i vlerësimeve të modifikuara këtë vit ka për qëllim tejkalimin më lehtësi të situatës dhe mirëqenien e nxënës. Në kushtet e zhvillimit të mësimin në distancë, vlerësimi i nxënësve do të mbështetet në këto parime:

### PARIMI 1 Vlerësimi formues paraqet bazë për vlerësimin përfundimtar

Vlerësimi formues është vlerësim që ndodhë në gjithë procesin e të nxënës i një shkalle të vogël që kryhet në nivelin e klasës, është ndërveprues, afatshkurtër, nxit reflektimin aktiv të mësimdhënësve dhe nxënësve dhe jep informacion për progresin e arritur. Mësimdhënësit e përdorin vlerësimin formues për të krijuar dëshmi sesi nxënësit po përparojnë në të nxënës e tyre, japin informata kthyesë nxënësve për t'i mbështetur në të nxënës e tyre dhe modifikojnë mësimdhënien për të qartësuar qëllimet e të nxënës. Dëshmitë e mbledhura për punën e nxënësve gjatë mësimin në distancë reflektohen në notën e vlerësimit përmbledhës, dhe si rrjedhojë në notën përfundimtare në fund të vitit mësimor/shkollor.

### Parimi udhëheqës

Në kushte të tanishme, qëllimi primar i vlerësimit është mirëqenia e fëmijëve dhe nxitja e të nxënës, e jo vlerësimi i përmbajtjes së mësuar.

<sup>1</sup> Upute za vrednovanje i ocjenjivanje tijekom nastave na daljinu, Ministarstvo znanosti i obrazovanja, Zagreb, prill 2020, f.4.

### PARIMI 2 Sjellja etike

---

Një aspekt që fiton rëndësi gjatë mësimit në distancë është edhe sjellja etike. Këtu përfshihet sjellja etike e mësimit në distancë gjatë përdorimit të platformave të ndryshme të komunikimit online, duke shmangur rreptësisht përmbajtje, mesazhe dhe simbole që nuk përkojnë me misionin dhe detyrën e mësimit në distancë/es. Njëkohësisht, mësimit në distancë duhet të jenë të vëmendshëm që me format e aplikuar të vlerësimit të ndikojnë në minimizimin e rasteve të kopjimit, mashtrimit dhe të bashkëpunimit të palejueshëm në mes të nxënësve gjatë vlerësimit. Për tejkalimin e situatave të tilla, ndihmon shumë përqendrimi në vlerësimin e proceseve më të larta mendore (si gjykimi, analiza, vlerësimi, kreativiteti e të tjera).

Mësimit në distancë duhet të kenë qasje të barabartë ndaj të gjithë nxënësve, të mos përdorin asnjë formë të trajtimit të veçantë dhe as paragjyqese gjatë mësimit në distancë, qoftë ndaj nxënësve që nuk zotërojnë shkathtësi të mira në TIK, por kryejnë të gjitha obligimet me përgjegjësi, po ashtu edhe kundrejt atyre që më herët nuk kanë pasur performancë të mirë e tash shfaqin interesim e kontribut të shtuar. Qasja afirmative mund të përdoret për nxënësit e merituar dhe për ata që kanë vështirësi në të nxënë.

### PARIMI 3 Mbështetja në normat ligjore

---

Siç është prezantuar më lart në parimin e parë, vlerësimi formues siguron informata të nevojshme edhe për vlerësimin përfundimtar, për çfarë do të nxirret një vendim i veçantë nga MASHTI. Nëse gjendja e jashtëzakonshme shëndetësore vazhdon për një kohë më të gjatë, MASHTI, sipas nevojës do të sjellë akte të tjera nënligjore që mundësojnë kritere dhe qasje në vlerësimin e nxënësve në përputhje me zhvillimin e mësimit në rrethana të jashtëzakonshme shëndetësore, konkretisht në kushte të pandemisë COVID- 19.

### PARIMI 4 Kujdesi për kategoritë e cenueshme

---

Gjatë zhvillimit të mësimit në distancë, kujdes i veçantë do t'u kushtohet edhe përkrahjes dhe identifikimit të mënyrave kreative të formave për vlerësimin e punës së nxënësve nga kategoritë e cenueshme, përfshirë fëmijët me nevoja të veçanta, si dhe fëmijët që jetojnë në kushte të vështira ekonomike dhe kanë qasje të kufizuara në mësimit në distancë.

### 3. Metoda dhe rekomandime të përgjithshme për vlerësim

Në këtë kapitull prezantohen qasjet, metodat dhe instrumentet e vlerësimit që rekomandohen gjatë mësimit në distancë. Me disa adaptime, këto qasje, metoda dhe instrumente janë të aplikueshme për të gjitha nivelet e arsimit, prandaj të gjithë mësimsdhënësit duhet ta lexojnë me kujdes këtë kapitull. Po fillojmë me disa rekomandime të përgjithshme lidhur me vlerësimin gjatë mësimit në distancë.

- a. Gjatë mësimit në distancë, vlerësimi me shkrim (testet, esetë argumentuese, provimet) mund të paraqesin problem për integritetin e vlerësimit. Prandaj, është shumë e rëndësishme që të shfrytëzohen aktivitete të shumëllojshme për vlerësimin e njohurive dhe shkathtësive të nxënësve, të përshtatshme për të mësuarit në distancë, me qëllim të nxitjes së nxënësve për marrjen e përgjegjësisë për punë sistematike dhe të pavarur.
- b. Duhet theksuar që mësimsdhënia në distancë kërkon që të shmangët përqendrimi në detajet e lidhura me faktet në dobi të vlerësimit të procesit të të nxënësve. Sugjerohet që mësimsdhënia të fokusohet në përmbajtjet thelbësore në mënyrë që nxënësve t'iu lejohet të kuptuarit e një konteksti më të gjerë, në funksion të të nxënësve të thellë që lidhet me përvojat e tyre.
- c. Vlerësimi duhet të paraqesë pasqyrimin më të saktë të punës së nxënësve, bazuar në atë që është mësuar gjatë mësimit në distancë, që është e arsyeshme dhe në interesin më të mirë të nxënësve gjatë kësaj kohe.
- d. Në kushtet e tanishme të mësimit në distancë, mësimsdhënësi/ja duhet të përzgjedhë me kujdes metodat e vlerësimit. Ato duhet të përshtaten me nivelin e përgatitjes së vetë mësimsdhënësit (e po ashtu edhe të nxënësve) për shfrytëzimin e mjeteve digjitale, me kushtet për punë që kanë nxënësve në shtëpi dhe natyrisht me pajisjet që janë në dispozicion.
- e. Prandaj, është më se i domosdoshëm një koordinim më i mirë i mësimsdhënësit, aktiveve profesionale, koordinatorëve të cilësisë, pedagogëve e psikologëve të shkollave dhe prindërve për përshtatjen e mësimit në distancë dhe të vlerësimit me kushtet e krijuara.

#### Me rëndësi:

- Shfrytëzoni aktivitete të shumëllojshme për vlerësim për të siguruar integritetin e vlerësimit;
- Më pak përqendrim në fakte, më shumë në procesin e të nxënësve;
- Përshtatini metodat sipas nivelit tuaj dhe të nxënësve për shfrytëzimin e teknologjisë;
- Këshillohuni me kolegët e aktivitetit profesional;
- Keni parasysh fëmijët me vështirësi në të nxënësve dhe ata me talente. Detyrat nuk kërkohet të jenë të njëjta për të gjithë.

- f. Detyrat nuk kërkohet të jenë të njëjta për të gjithë nxënësit. Është e nevojshme të merren parasysh edhe nxënësit me nevoja të veçanta, dhe nxënësit e talentuar Mësimdhënësit, në bashkëpunim me koordinatorët e cilësisë dhe me menaxhmentin e shkollës, duhet, që edhe në këto rrethana, të bëjnë përshtatjen dhe individualizimin e mësimdhënies. Detyrat që u kërkohen nxënësve duhet të përshtaten me aftësitë e nxënësve në mënyrë që të përfitojnë të gjithë, siç janë nxënësit me vështirësi në të nxënë apo edhe ata të talentuar. Mësimi në distancë kërkon një harmonizim dhe balancim edhe midis kohës dhe përfshirjes së kërkesave për realizimin e detyrave me nevojat e nxënësve.

### 3.1. Vlerësimi i nxënësve sipas kërkesave kurrikulare dhe modaliteti i vlerësimit në distancë

Vlerësimi i nxënësve sipas kërkesave kurrikulare bazohet në rezultatet e të nxënit për kompetenca (RNK), rezultatet e të nxënit për fushë kurrikulare (RNF) dhe rezultatet e të nxënit për lëndë mësimore (RNL). Sipas Kornizës Kurrikulare (2016), qëllimi kryesor i vlerësimit është mbështetja e të nxënit të nxënësve. Ky qëllim, së bashku me parimet e vlerësimit për mësimin në distancë, duhet të udhëheqin procesin e vlerësimit në distancë.

Referuar dokumenteve kurrikulare dhe Vendimit të MASHTI për procedurat e realizimit të vlerësimit të nxënësve gjatë mësimin në distancë, vlerësimi formues dhe vlerësimi përfundimtar janë vlerësime që zbatohen nga mësuesi, respektivisht mësimdhënësi i lëndës mësimore përkatëse, të cilat **do të realizohen të integruara gjatë mësimin në distancë**, pa pasur nevojë të ndahen në vlerësim sipas periudhave mësimore dhe ndarje në vlerësime përmblendhëse VP1 dhe VP2 në nivelet e arsimit II dhe III.

### 3.2. Vlerësimi gjatë pandemisë COVID-19

Në rrethanat e krijuara nga Pandemia COVID-19, **rekomandohet të vlerësohet ajo çka është thelbësore** për detyrat, angazhimet, veprimtaritë praktike dhe rezultatet e të nxënit, që ndërlidhen me llojin e mësimin që zhvillohet dhe qasjet në mësimdhënie që aplikohen gjatë mësimin në distancë. Po ashtu, disa nxënës do t'u referohen detyrave që rrjedhin gjatë video-paraqitjeve në televizionin publik dhe mësimdhënësit duhet t'i përcjellin këto kërkesa me vëmendje në mënyrë që të mos i mbingarkojnë dhe të mos shkaktojnë ngatërrim tek nxënësit. Theksi duhet të vihet në mirëqenien e nxënësve dhe më shumë në nxitjen për të mësuar, sesa në vlerësimin e asaj se çfarë kanë mësuar.

### 3.2.1. Vlerësimi formues gjatë mësimit në distancë

Në kushtet e realizimit të mësimit në distancë, vlerësimi formues/ vlerësimi për të nxënë rekomandohet të fokusohet më shumë në ofrimin e informatave kthyesë me qëllim të përmirësimit të të nxënës dhe në motivimin e nxënësit për nxënie të mëtejshme. Metodatat dhe teknikat e vlerësimit formues/ vlerësimit për të nxënë në rrethanat e mësimit në distancë, mund të dallojnë nga klasa në klasë, nga lënda në lëndë, në varësi nga qasja e mësimdhënies që ofrohet dhe mundësitë teknike që i kanë në dispozicion mësimdhënësit dhe nxënësit. Ato mund të jenë: ushtrime kontrolluese, pyetje, ese, detyra hulumtuese, debate, teste të njohurive nga ndonjë platformë që lehtë përdoret nga nxënësit, portfolio elektronike e të tjera. Informata kthyesë për nxënës/it duhet të praktikohen më gojë dhe/apo me shkrim. Ato, duhet të jenë pozitive, nxitëse, sqaruese, korrigjuese, zhvilluese dhe vlerësuese. Mësimdhënësit rekomandohet të mbajnë evidencë në ditarin e tyre personal për metodatat dhe teknikat e shfrytëzuara dhe informatat kthyesë të dhëna për nxënës dhe për përparimin e nxënësve.

#### Metodat dhe teknikat e vlerësimit formues

Ushtrime kontrolluese, pyetje, ese, detyra hulumtuese, debate, teste të njohurive nga ndonjë platformë që lehtë përdoret nga nxënësit, portfolio elektronike.

### 3.2.2. Vlerësimi përfundimtar gjatë mësimit në distancë

Vlerësimi përfundimtar në rrethanat e realizimit të mësimit në distancë udhëhiqet nga parimet e këtij udhëzuesi. Mësimdhënësit, vlerësimin përfundimtar, duhet ta konsiderojnë më shumë si një proces të vendosjes së notës në bazë të angazhimit të nxënësit dhe përfundimeve të nxjerra nga vlerësimi formues e përmbledhës. Në kohën sa zhvillohet mësimi në distancë, mësimdhënësit nuk duhet të nxitojnë me vlerësim përmbledhës, por t'i përkushtohen kërkesave për vlerësim formues. Kjo vlen si për klasat ku punohet me kurrikulën e bazuar në kompetenca, ku vlerësimi është i organizuar në tri periudha mësimore, ashtu edhe për klasat 4, 5, 9 (sipas kurrikulës së mëhershme) dhe shkollat profesionale ku vlerësimin e kanë të organizuar në dy gjysmëvjetorë.

Për përmbushjen e qëllimeve të vlerësimit përfundimtar gjatë mësimit në distancë, mësimdhënësit rekomandohen që përmes detyrave të shtëpisë, projekteve e formave të tjera, të angazhojnë nxënësit në procese të menduarit e nivelit më të lartë, të aplikojnë metodatat e ndryshme të vlerësimit që përfshijnë edhe nxënësit në këtë proces, dhe t'i kushtojnë kujdes komunikimit të ndërsjellë që ndihmon në sigurimin e dëshmive për përparimin e nxënësit, siç është sugjeruar në seksionin 3.3 dhe kapitullin 4 të këtij Udhëzuesi. Format e punës për të siguruar dëshmi të angazhimit të nxënësve në detyra, projekte dhe aktivitete të tjera, si dhe metodatat e instrumentet e vlerësimit, me qëllim të arritjes të vlerësimit përfundimtar, mësimdhënësi i përcakton vetë, gjithnjë duke pasur në kujdes evitimin e mbingarkimit të nxënësve. Këto forma të punës përzgjidhen në varësi të:

- mundësive teknike të pjesëmarrjes së nxënësve në mësimin në distancë dhe në vlerësime të tilla;
- numrit javor të orëve mësimore për lëndë;
- kohës së mësimit me nxënës në rrethana të mësimit në distancë; dhe të
- mundësive teknike që sigurojnë cilësi në vlerësimin e nxënësve.

Nota përfundimtare e vitit mësimor/shkollor është pasqyrë e vlerësimit të punës së nxënësve para ndërprerjes së mësimit të rregullt në shkollë (11 mars) dhe e vlerësimit formues të realizuar gjatë mësimit në distancë. Nota përfundimtare nuk duhet të jetë më e ulët se nota ekzistuese e datës 11 mars.

Në rastet e veçanta, nëse për ndonjë arsye objektive, siç është pamundësia e nxënësit që të marrë pjesë në mësimin nga distanca ose kur mësimdhënësi i fushës/lëndës kurrikulare nuk ka arritur të mbledhë dëshmi të mjaftueshme për punën e nxënësit, ai/ajo i do t'i mundëson nxënësit t'i nënshtrohet vlerësimit përfundimtar përmes njëres nga metodat standarde ose inovatore të përshkruara në këtë udhëzues (3.3.1 dhe 3.3.2).

Në situatën e tanishme është e mundur që një numër i nxënësve, për shkaqe objektive, të mos jenë në gjendje ta ndjekin me rregull mësimin në distancë, pra edhe t'i shtrohen vlerësimit formues gjatë mësimit në distancë. Rastet e tilla mund të arsyetohen për shkak të sëmundjes, mungesës së pajisjeve për komunikim, ose rrethanave të tjera jetësore jashtë ndikimit të nxënësit, gjithnjë sipas vlerësimit të shkollës. Në vijim janë prezantuar dy skenarë për vlerësimin e nxënësve që, për shkaqe objektive, nuk kanë ndjekur rregullisht mësimin online.

**Skenari 1** Nëse procesi mësimor vazhdon përmes mësimit në distancë deri në fund të vitit mësimor/shkollor, nxënësi që për arsye objektive nuk ka ndjekur rregullisht mësimin, i nënshtrohet një vlerësimi përfundimtar për atë se çfarë është mësuar gjatë mësimit në distancë, përmes njëres nga metodat standarde dhe novatore të vlerësimit në distancë: (i) Testi me shkrim online; (ii) Detyra përmbledhëse; (iii) Projekti hulumtues; (iv) Zgjidhja e problemeve; dhe (v) Provimi me gojë përmes ndonjëres nga platformat e aplikueshme.

**Skenari 2** Nëse procesi mësimor rikthehet dhe vazhdon në kuadër të institucioneve edukative arsimore para përfundimit të vitit shkollor, nxënësi që për arsye objektive nuk ka ndjekur rregullisht mësimin, i nënshtrohet një vlerësimi përfundimtar për atë se çfarë është mësuar gjatë mësimit në distancë dhe pas rikthimit në shkollë, përmes njëres nga metodat standarde të vlerësimit: (i) Testi me shkrim; (ii) Detyra përmbledhëse; (iii) Projekti hulumtues; (iv) Zgjidhja e problemeve; (v) Provimi me gojë; (vi) Prezantimi i nxënësit.

Pos këtyre skenarëve, në rastet kur nxënësi është i/e pakënaqur me notën përfundimtare, i nënshtrohet një vlerësimi përfundimtar përmes njëres nga metodat standarde të vlerësimit: (i) Testi me shkrim; (ii) Detyra përmbledhëse; (iii) Projekti hulumtues; (iv) Zgjidhja e problemeve; (v) Provimi me gojë; (vi) Prezantimi i nxënësit.

### 3.3. Metodatat e vlerësimit gjatë mësimit në distancë

Në rrethanat e mësimit në distancë pritet që mësime të zbatohen disa qasje standarde dhe qasje kreative e ndërvepruese që sigurojnë mbështetjen e të nxënësve, i cili është qëllimi kryesor i vlerësimit.

#### 3.3.1 Metodatat standarde

Metodatat standarde të vlerësimit në kushtet e mësimit në shkollë, përfshijnë ato të bazuara në kontrollimin e detyrave, vlerësimin me gojë dhe me shkrim (teste, provime), etj. Prandaj, referuar mundësive dhe përvojës së mësime të zbatueshme, rekomandohet që këto metoda standarde të praktikohen edhe gjatë vlerësimit në distancë. Përdorimi i metodave/qasjeve standarde të vlerësimit në distancë dhe shpeshësia e tyre varet nga lëndat mësimore (përfshirë edhe fondin javor të orëve mësimore), temat mësimore, njësitë mësimore që zhvillohen gjatë mësimit në distancë dhe veçanërisht nga rezultatet e të nxënësve që duhet të maten dhe të vlerësohen.

- a. **Kontrollimi i detyrave.** Detyrat e shtëpisë në të shumtën e rasteve udhëzohen nga mësime të zbatueshme që të merren nga librat bazë për nxënës, të dedikuar për punë të pavarur. Por, në raste të tjera, për detyrë shtëpie mund të konsiderohen edhe aktivitetet e tjera, si për shembull, ‘hulumtimet’ në kuadër të realizimit të projekteve, reflektimet e nxënësve apo formulimet e problemeve dhe zgjidhjet e tyre nga vetë nxënësve.

#### Disa kritere për vlerësimin e detyrave

- Dorëzimi me kohë (brenda afateve të arsyeshme)
- Angazhimi i nxënësve
- Kreativiteti
- Saktësia në rezultate
- Ecuria

Duke marrë parasysh se në klasat virtuale, jo gjithmonë është e mundur që nxënësve të marrin informata kthyesë për detyrat e kryera, udhëzohet/rekomandohet që për detyrat e shtëpisë të jepen edhe pyetje që i mundësojnë nxënësve të vetëreflektojnë, kurse mësime të zbatueshme, të informohet më mirë për nevojat e nxënësve për përmirësime eventuale. Këto informata janë shumë të vlefshme që mësime të zbatueshme mund t'i shfrytëzojë si udhëzime për punën individuale me nxënës. Një shembull që mund të përdoret për pyetjet që lidhen me detyrat e shtëpisë është fleta me tri pyetje (“Reflektimi im”):

- Cila ishte ideja kryesore që mësime të zbatueshme sot?
- Çfarë është diçka për të cilën keni ende paqartësi, dyshime ose për të cilën keni pyetje?
- Si mund të shfrytëzoni idetë nga mësime të zbatueshme që zhvilluat sot në jetën e përditshme?

Reflektimet e tilla i bëjnë nxënësve të vetëdijeshëm për rëndësinë që ka kryerja e detyrave në mënyrë të pavarur dhe i bëjnë ata të marrin përgjegjësinë për të nxënësve të tyre. Mësime të zbatueshme duhet të kenë kujdes për vëllimin e detyrave, strukturën dhe përmbajtjen e tyre, në raport me moshën e nxënësve, temën/njësinë mësimore dhe rezultatit e të nxënësve që mund të shpërfaqet nëpërmjet detyrave dhe hapave të aplikuar për realizimin e tyre. Mësime të zbatueshme duhet të përdorin kritere të vlerësimit për detyrat që kontrollohen, si dorëzimin me kohë, an-

gazhimin e treguar të nxënësit në detyra, format alternative dhe kreative të kryerjes së detyrave, saktësinë në rezultatet e detyrave dhe në respektimin e hapave dhe procedurave të domosdoshme. Lidhur me dorëzimin me kohë, mësimdhënësit duhet të vendosin afate që mbesin në suaza të mobilizimit kreativ dhe që nuk shkaktojnë presion dhe frustrim të tepruar tek nxënësit. Detyrat duhet të jenë sipas një modeli të punës individuale, që mban nxënësin të angazhuar, shmang kopjimet dhe inkurajon nxënësin për punë të pavarur.

- b. Vlerësimi me shkrim online.** Për përdorimin e metodës së vlerësimeve me shkrim, mësimdhënësit mund të shfrytëzojnë pyetësoarin dhe kuizin si mjet për të përpiluar teste me detyra dhe pyetje me zgjedhje të shumëfishtë, pyetje të hapura, pyetje me plotësim dhe përgjigje të shkurtra. Kërkesat/pyetjet që shtrohen për vlerësimin e nxënësve duhet të sigurojnë standardet minimale për nivelet e vështirësive, veçantitë e klasave dhe nxënësve, përfshirë ato të nxënësve me nevoja të veçanta. Ka mundësi të shumta për ndarjen e materialeve me nxënës dhe bashkëveprimin me ta përmes platformave online që përdorin shkollat. Në disa lëndë si në matematikë, fizikë apo kimi, është e zakonshme të kontrollohen jo vetëm saktësia e përgjigjeve, por edhe procesi i zgjidhjes së detyrave. Në këto raste, mësimdhënësit mund të kërkojnë nga nxënësit të shtojnë një fletë për shpjegimet e zgjidhjeve që mundësohet nga platformat përkatëse ose të fotografojnë zgjidhjet dhe të dërgohen në kohën e caktuar përmes aplikacionit që përdoret për komunikim. Kjo e dyta është e mundshme të realizohet edhe në rastet kur ka pengesa për shfrytëzim të pajisjeve dhe platformave të veçanta.

Që të shmangen shqetësimet për integritetin e përgjigjeve, pra nëse nxënësi i ka zgjidhur detyrat në mënyrë të pavarur, mund të jetë ndihmues fakti që mësimdhënësit kryesisht i njohin nxënësit e tyre, dhe nëse e përcjellin vazhdueshëm përparimin e tyre në faza të ndryshme të procesit të të nxënës. Pas kontrollimit të testeve mund të organizohet një intervistë/provim me gojë i shkurtër, në mënyrë që mësimdhënësi të sqarojë vështirësitë që janë paraqitur gjatë zgjidhjes së detyrave, dhe se ku duhet përmirësuar në të ardhmen. Kombinimi i vlerësimit me shkrim online me vlerësimin me gojë mund të organizohet edhe në rastet e veçanta kur ka kërkesa nga nxënësit për arritjen e një note më të madhe ose kur është e pamundur që nxënësi të përfshihet në provimin me shkrim. Gjithsesi, në secilin rast duhet të respektohet liria e veprimit e mësimdhënësit/es. Mësimdhënësit do të jenë të kujdesshëm të mos ngarkojnë nxënësit me teste të teprta për të mos krijuar tension e frustrim tek nxënësit.

- c. Vlerësimi me gojë online.** Mënyra më e thjeshtë e vlerësimit me gojë është përmes video-takimeve virtuale që mund të mbahen drejtpërdrejtë përmes platformave që mësimdhënësit i përdorin lehtësisht me nxënësit e tyre. Rekomandohet që vlerësimi me gojë të mos realizohet në secilën lëndë mësimore, pasi do të ngarkonte në mënyrë të panevojshme mësimdhënësit dhe nxënësit, si dhe realizimin e mësimin në distancë, referuar qëllimeve të tij. Sidoqoftë, për lëndët mësimore që kanë fond javor të orëve mësimore 4 orë e më shumë, vlerësimi me gojë që ka ndikim në notën e periudhës mësimore përfundimtare, duhet të bëhet një herë deri në fund të vitit mësimor, në mënyrë të veçantë nëse mësimdhënësi dhe nxënësi kanë

Vlerësimi me gojë të bëhet **vetëm një herë deri në fund të vitit mësimor**, në rastet kur vlerësimi ka ndikim në notën përfundimtare. Vlerësimi me gojë të bëhet në lëndët mësimore që kanë 4 orë mësimore ose më shumë në javë.

Ndërkaq, në lëndët mësimore që kanë 3 ose më pak orë mësimore në javë, vlerësimi me gojë bëhet vetëm në raste të veçanta.



dilema në notën e periudhës mësimore, respektivisht në notën përfundimtare. Për lëndët mësimore, me fond 3 e më pak orë në javë, rekomandohet që vlerësimi me gojë gjatë mësimit në distancë të praktikohet vetëm në rastet kur mësimdhënësi konstaton se ka elemente të pamjaftueshme për të përfunduar një vlerësim me notë maksimale, siç është vlerësimi me notë shkëlqyeshëm.

### 3.3.2. Metodatat inovatore (kreative dhe ndërvepruese)

Me paradigmen e re të mësimdhënies që e kërkon Kurrikula e Kosovës, nxënësi duhet të jetë aktiv në të gjitha vepërimitaritet që zhvillohen në klasë dhe jashtë saj. Kjo kërkesë duhet të merret parasysh edhe në klasat virtuale. Përzgjedhja me kujdes e metodave të mësimdhënies duhet të ketë parasysh edhe vlerësimin, si proces i rëndësishëm që “drejton të nxënësit”. Prandaj, në mjedisin virtual, ne kemi mundësinë të aplikojmë një numër të madh të metodave inovatore të vlerësimit që janë më të përshtatshme për vlerësimin e niveleve më të larta të proceseve njohëse, por edhe më stimuluese për nxënësit.

Reflektimet për detyrat e shtëpisë, zhvillimi i e-portfoliove, projektet, kuizet, zgjidhja e problemeve, janë disa nga metodatat inovatore që janë treguar të suksesshme për t’u zbatuar gjatë procesit të të nxënësit. Metodatat e tilla konsiderohen si mjete nxitëse dhe motivuese për angazhim më të madh të nxënësve në procesin mësimor. Ato u mundësojnë nxënësve të kontrollojnë të kuptuarit e tyre, të kryejnë detyra të caktuara dhe në të njëjtën kohë të jenë kreativë në zgjidhjen e detyrave dhe problemeve me kontekste më të përgjithshme.

Aktivitetet e tilla janë të përshtatshme të shfrytëzohen nga mësimdhënësi të të gjitha niveleve, e sidomos janë të përshtatshme të shfrytëzohen nga mësimdhënësit e lëndëve që nuk transmetohen në RTK (përfshirë lëndët zgjedhore).

Përdorimi i metodave të shumëllojshme të vlerësimit dhe shpeshësia e tyre varet nga temat, nëntemat, njësitë mësimore që zhvillohen gjatë mësimit në distancë dhe veçanërisht nga rezultatet që priten të përmbushen nga nxënësit. Por, nuk duhen anashkaluar edhe faktorët e tjerë ekonomikë e socialë. Më poshtë po i prezantojmë disa metoda inovatore për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit online.

#### a. Portfolio elektronike

Që të vlerësohet saktë e drejt përparimi i nxënësve, një mjet gjithashtu i rëndësishëm është portfolio ose dosja e nxënësit/es. Ajo paraqet një ‘koleksion’ të qëllimshëm të punës së nxënësve dhe tregon për përpjekjet, përparimin dhe të arriturat e tij/saj në një lëndë/fushë të caktuar. Disa udhëzime për vlerësimin me portfolio elektronike:

- Filloni me më pak kërkesa nëse keni numër të madh të nxënësve.
- Arsyetoni: Cili është qëllimi i mbajtjes së portfolios? Njoftoni qartë nxënësit dhe prindërit e tyre për kriteret e vlerësimit. Paraqitni shembuj të punës që do të jenë pjesë e portfolios.
- Përcaktoni kohën e shqyrtimit të portfoliove dhe dhënies së informatave kthyesë në mënyrë që nxënësit të marrin udhëzime të sakta dhe të përmirësojnë punën e tyre.
- Caktoni qartë kriteret e vlerësimit dhe nëse do të vlerësoni vetëm shembujt e përmirësuar apo edhe punën fillestare. A do të kërkonte reflektim me shkrim? Nëse portfolio do të shfrytëzohet për vlerësim përmblendhës tregoni cilat janë kriteret?

Pra, portfolio elektronike në mësimin në distancë mund të shfrytëzohet jo vetëm për vlerësimin e njohurive të nxënësve, por njëkohësisht edhe për zhvillimin e shkathtësive dhe vlerave pozitive për punë.

Kriteret për informata kthyesë lidhur me vlerësimin e përmbajtjes së portfolios rekomandohet të jenë:

- Kryerja me rregull e detyrave të shtëpisë: angazhim i vazhdueshëm në kryerjen e të gjitha detyrave me shkrim.
- Saktësia e detyrave të shtëpisë: janë dërguar me kohë, kanë qenë të sakta ose janë kthyer me sugjerime (sa herë).
- Cilësia dhe origjinaliteti e kreativiteti i provave, reflektimeve, vetëvlerësimit: sa janë origjinale, mënyra/procedurat e zgjidhjeve, ndikimi në plotësimin e njohurive, shkathtësive dhe shprehive e vlerave të nxënësit.
- Struktura e punimeve të pavarura: Aspekti gjuhësor, të shprehurit, logjike e radhitjes, objektiviteti i vetëvlerësimit.
- Saktësia dhe kreativiteti i përgjigjeve në pyetjet e bëra lidhur me temat e caktuara.

### b. Zgjidhja e problemeve

Mësimi në distancë mundëson të shfrytëzohet të nxënët nëpërmjet zgjidhjes së problemeve i cili paraqet një mjet të fuqishëm që nxit shumëfish të menduarit kreativ dhe krijues. Krijimi i një mjedisi virtual ku nxënësit hulumtojnë dhe angazhohen në një sërë strategjish për zgjidhjen problemeve i aftëson ata të eksplorojnë alternativat dhe të zhvillojnë vetëbesimin e tyre për të mësuar. Detyra për zgjidhjen e problemit përmban këto elemente: a) përcaktim dhe identifikim i problemit; b) analizë e problemit; c) identifikim i zgjidhjes së mundshme; d) përzgjedhje e zgjidhjes më të mirë; e) vlerësim i zgjidhjes; f) zhvillim i një plani veprimi; g) paraqitje e zbatimit. Problemet mund të jenë të asaj natyre që, për zgjidhjen e tyre nxënësit duhet të hulumtojnë në Internet, duke shfrytëzuar edhe shkathtësitë e tyre gjuhësore.

### c. Vlerësimet e shpejta (kuizet)

Kur vlerësohen njohuritë për të kuptuarit e koncepteve apo shkathtësitë për përdorim të saktë të procedurave zakonisht përdoren teste ku pyetjet mund të kenë dy përgjigje (apo alternativa), shumë alternativa, me çftime apo me plotësime. Por nuk duhet anashkaluar edhe testet ku duhet arsyetuar përgjigjet apo kur duhet dhënë shpjegim për procedurën e zgjidhjes. Detyrat e përfshira në teste të tilla duhet të jenë në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënët dhe zhvillimit të aftësive të nxënësve për të arsyetuar, argumentuar dhe për të menduar në mënyrë kritike e kreative. Nëpërmjet zgjidhjes së detyrave/problemeve qoftë të atyre që kërkojnë nivel të ulët të njohjes, apo edhe të atyre që kërkojnë të menduar të nivelit të lartë, fokusi duhet të jetë tek arritja e rezultateve të të nxënët.

Për të ndihmuar nxënësit që të jenë të suksesshëm, pas çdo tërësie, është mirë të organizohet një test i shkurtër për të vlerësuar nëse ka mangësi apo keqkuptime në lidhje me njësitë e zhvilluara. Ngjashëm si të testet me shkrim, mund të shfrytëzohen platforma të ndryshme, për të bërë të dukshëm komunikimin midis mësimeve dhe nxënësve.

## Shembull i portfolios së nxënësit

3 detyra të shtëpisë

2 shembuj të shënimeve gjatë mësimin në distancë

3 teste/detyra kontrolluese

1 shembull i kontributit në punën ekipore

1 shembull i punës në projekt mësimor

Kuizet që merren në internet (apo të përgatitura nga mësime dhënësit) ofrojnë informacione që japin informata kthyesë për të bërë modifikime të nevojshme për përmirësimin e të nxënësve.

### d. Mësimi i bazuar në projekte

Mësimi i bazuar në projekte i referohet çdo qasjeje programatike që ndihmon nxënësit të bashkëpunojnë dhe të zhvillojnë shkathtësi për jetë dhe punë. Kjo qasje është metodë e mësime dhënies me qendër nxënësin, e cila mbështet mësimin nëpërmjet angazhimit të nxënësve në një hetim të një teme për të mësuar më shumë dhe për të zgjeruar njohuritë e tyre në lidhje me atë temë. Pra, mësimi i bazuar në projekte është i lidhur ngushtë me konceptin e mësimit autentik, për të trajtuar problemet dhe çështjet e botës reale. Gjatë punës me projekte, nxënësve u kërkohet të hetojnë dhe analizojnë kompleksitetin, ndërlidhjet dhe paqartësitë e tyre. Për këtë arsye, mësimi i bazuar në projekte mund të quhet edhe mësim i bazuar në hetim, ose të nxënësve duke bërë. Për vlerësimin e punës bashkëpunuese të nxënësve shfrytëzohen rubrikat e vlerësimit, të cilat mësime dhënësi/ja i ndan paraprakisht me nxënësit. Kërkesat e paraqitura në këto rubrika u shërbejnë nxënësve si udhëzime për punën që duhet të bëjnë në mënyrën më të mirë.

Projektet e tilla gjatë të mësuarit në distancë mund të jenë detyra për të nxitur bashkëpunimin ndërmjet nxënësve, por mësime dhënësi duhet të sigurohet se një bashkëpunim i tillë është i mundshëm edhe kur ata punojnë nga shtëpitë e tyre.

## 3.4. Menaxhimi i vlerësimit

Siç është thënë në hyrje, ky Udhëzues nuk ofron zgjidhje të gatshme për vlerësimin e nxënësve, por ide për veprim që duhet zbatuar duke i'u përshtatur kontekstit dhe rrethanave. Mirëpo, edhe në rrethanat e vazhdimin të mësimit në distancë, kërkohet menaxhim korrekt i vlerësimit, si një parakusht për të arritur qëllimet e vlerësimit në distancë, duke iu referuar parimeve të vendosura në këtë udhëzues. Sigurimi i evidencave dhe dëshmitë të vlerësimit, monitorimi i procesit dhe raportimi, përbëjnë bazën e menaxhimit të vlerësimit në distancë. Ato kërkojnë që:

- Mësime dhënësi në ditarin e tij personal të vlerësimit të mban evidencat e vlerësimit dhe shkruan komente shtesë, për secilin nxënësi;
- Mësime dhënësi në përfundim të vitit mësime/shkollor të përgatit një formë të raportit të shkurtër për metodat e vlerësimit të aplikuar gjatë vlerësimit në distancë, argumentet se pse janë përdorur ato dhe si janë zbatuar. Raporti i dërgohet drejtorisë së shkollës;
- Mësime dhënësi në fund të vitit mësime/shkollor, referuar ditarit personal të vlerësimit, vendos notën përfundimtare të secilit nxënësi dhe raporton në organet e shkollës, sipas procedurave të kërkuara në rrethanat e pandemisë. Në rast se kërkohen sqarime shtesë, ato duhet të argumentohen me evidencat dhe dëshmitë e vlerësimit nga ditarit personal i vlerësimit dhe metodat e instrumentet e vlerësimit të aplikuar;
- Drejtorët e shkollave duhet të jenë në kontakt të vazhdueshëm me mësime dhënësi, të monitorojnë procesin, të ofrojnë përkrahjen e nevojshme dhe të raportojnë në fund të vitit mësime/shkollor.

Një format i raportimit i sugjeruar për metodat e vlerësimit të aplikuar gjatë vlerësimit në distancë, është dhënë në vijim.

## UDHËZUES PËR VLERËSIMIN E NXËNËSVE GJATË MËSIMIT NË DISTANCË

Mësimdhënësi: \_\_\_\_\_

Klasa/lënda kurrikulare: \_\_\_\_\_

Metoda të vlerësimit të aplikuara gjatë mësimit në distancë	Argumentet kryesore për përzgjedhjen e metodës së vlerësimit të përdorur gjatë mësimit në distancë	Përshkrim i shkurtër i metodologjisë së si është zbatuar metoda gjatë vlerësimit të nxënësve
1.		
2.		
..		

## 4. Modalitetet e vlerësimit në raste specifike

Në kapitullin 3 janë prezantuar metoda dhe rekomandime të përgjithshme për vlerësimin gjatë mësimit në distancë, të cilat, me pak modifikime, mund të aplikohen për të gjitha grupmoshat dhe lëndët mësimore. Ndërkaq, kapitulli 4 zbërthen disa modalitete të vlerësimit për raste specifike, siç janë nivelet e ndryshme të shkollimit, lëndët artistike dhe fëmijët me nevoja të veçanta. Mësimdhënësit mund t'u referohen pjesëve të veçanta të kapitullit 4, varësisht nga nevojat e tyre, pa qenë të detyruar t'i lexojnë edhe ato pjesë që nuk kanë të bëjnë me detyrat e tyre të punës. Megjithatë, është e domosdoshme që, para se të përzgjedhë çfarë do të lexojë nga kapitulli 4, secili mësimdhënësi **t'i lexojë me kujdes dhe në tërësi kapitujt 1-3 të këtij Udhëzuesi.**

### 4.1. Vlerësimi në nivelin parafillor

Vlerësimi në fëmijërinë e hershme bëhet për të mbledhur informacion rreth zhvillimit dhe të nxënit të fëmijës, nga mjedisi mundësues dhe nga gjithë veprimtaria edukative që organizohet nga edukatorët dhe prindërit, me qëllim mbështetjen dhe ndihmën për fëmijën në procesin e zhvillimit dhe të nxënit të tij. Veprimtaritë dhe aktivitetet e përditshme si përfshirja dhe angazhimi në lojë dhe aktivitete individuale apo në grupe (me fëmijë dhe të rritur), vizatimi, këndimi, vallëzimi, ndërtimi i blloqeve, bisedat me fëmijë dhe të rritur, ushtrimet fizike, ushqimi, pushimi, etj., janë bazë e vlerësimit në fëmijërinë e hershme. Referuar këtyre kërkesave dhe kushteve të mësimit në distancë, vlerësimi në fëmijërinë nuk mund të bëhet pa bashkëpunimin me prindërit.

Mjedisi dhe gjendjet emocionale të fëmijëve mund të ndikojnë në pjesëmarrjen dhe angazhimin e fëmijës në veprimtari edukative, prandaj këto duhet të merren në konsideratë gjatë vlerësimit në fëmijërinë e hershme, pra edhe në nivelin parafillor. Vlerësimi i fëmijëve në vitet e fëmijërisë së hershme është relativisht sfidues. Procesi i vlerësimit të asaj që fëmijët e vegjël dinë dhe mund të bëjnë, paraqet sfida të veçanta, dhe vlerësimi i fëmijëve shpesh është “jo i besueshëm”, pasi performanca e fëmijëve të vegjël nuk është domosdoshmërisht e qëndrueshme edhe për periudha të shkurtra kohore. Ndikimet e ambientit dhe gjendjet emocionale të fëmijëve mund të ndikojnë në mënyrën se si ata dalin në vlerësime. Për më tepër, fëmijët e vegjël zhvillohen me ritme shumë të ndryshme dhe modelet e tyre të zhvillimit dhe të nxënit mund të jenë episodike, të pabarabarta dhe të shpejta.

Është e rekomandueshme që vlerësimi tek fëmijët e moshës parafillore të përqendrohet në:

- situatat reale që pasqyrojnë atë çka fëmija bën aktualisht;
- vëzhgimet dhe detyrat që ndodhin në kontekstin e lojës së rregullt ose aktiviteteve;
- interaktivitetin e fëmijëve që rezultojnë në informacion rreth aftësisë së fëmijëve për të ndërvepruar me mjedisin e përditshëm;
- origjinalitetin e sjelljes, duke krijuar mundësi të shumëfishta e të shpeshta për të treguar një sjellje ose aftësi, e të tjera.

Duke pasur parasysh situatën e krijuar me pandeminë COVID-19, MASHTI, nga data 15.04.2020, ka lansuar platformën online “Edukimi në Distancë – Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0-6

vjeç”. Kjo platformë është krijuar, me qëllim të mbështetjes së prindërve/kujdestarëve ligjorë, fëmijëve dhe edukatorëve në realizimin e aktiviteteve ditore me fëmijët në kushte shtëpie. Përmbajtja e aktiviteteve të prezantuara në këtë Platformë, stimulon fëmijët në zhvillimin e tyre në të gjitha fushat zhvillimore në varësi të moshës së tyre si në atë fizike, njohëse, emocionale, matematikore dhe të kreativitetit. Andaj, aktivitetet që do të realizohen gjatë kësaj periudhe në kushte shtëpie për fëmijët e moshës 0-6 vjeç, do të realizohen nga prindërit/kujdestarët ligjorë, bashkë me fëmijët e kësaj grup moshe.

Pjesë e platformës online është edhe Formulari i Raportimit të edukatoreve në baza javore. Ky raport plotësohet nga edukatorët e grupit për të dëshmuar bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre për prindërit gjatë realizimit të aktiviteteve ditore/javore, në kushte shtëpie të paraqitura në platformën Edukimi në Distancë-Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë e hershme 0-6 vjeç. Edukatorët përmes këtij raporti, do të përshkruajnë aktivitetet javore të realizuara sipas platformës online, përcjellin përmes bashkëpunimit me prindërit/kujdestarët ligjor, numrin e fëmijëve të angazhuar në aktivitete përmes mjeteve dhe platformave të ndryshme teknologjike dhe do të reflektojnë mbi aktivitetet e javës dhe përfshirjen e fëmijëve në këto aktivitete duke dëshmuar edhe me fotografi angazhimin e fëmijëve. Pra në këtë periudhë edukatoreve të të gjitha grup-moshave, do t’ju duhet të krijojnë dosjet (portfoliot) për secilin fëmijë të grupit, e cila është mjet i rëndësishëm për të komunikuar jo vetëm për të mësuarit e një fëmije, por gjithashtu për të ofruar dëshmi për të mbështetur konkluzionet e edukatoreve në lidhje me pikat e forta, aftësitë dhe shkathtësitë e fëmijëve.

Dosja përmban shembuj të punës së fëmijëve në angazhimin e tyre në aktivitete në fusha të ndryshme përgjatë kësaj periudhe të qëndrimit në familje. Këta shembuj duhet të përfaqësojnë punën tipike të fëmijës (jo vetëm më të mirën ose më të keqen) dhe të tregojnë procesin e angazhimit të fëmijëve (jo vetëm produktin final). Po ashtu, dosjet përmbajnë edhe shënime të shkurtra, domethënëse, faktike nga edukatorët, të dala nga vëzhgimi i fëmijëve, ose nga informacionet që ka marrë nga prindi/kujdestari. Dosja duhet të ofroj informacion se si fëmijët janë duke përparuar në një fushë të caktuar ose në zhvillimin e një aftësie. Sa më e pasur të jetë dosja e fëmijëve me ‘punë’ të fëmijëve, aq më lehtë do ta ketë edukatorja për të vërejtur dhe për të qenë e sigurt në përparimin e tyre. Për t’iu përgjigjur situatës së krijuar, për këtë vit do të jetë i mjaftueshëm vlerësimi përshkruar vjetor i fëmijëve sipas fushave të zhvillimit.

Roli i edukatoreve në këtë proces është bashkëpunimi me prindërit në dhënien e mbështetjes në realizimin e aktiviteteve ditore me fëmijët dhe marrja e informatës kthyesë nga prindërit për angazhimin e fëmijëve në aktivitetet e organizuara.

## 4.2. Vlerësimi në arsimin fillor

Vlerësimi i arritjeve të nxënësit në arsimin fillor (klasat 1-5) gjatë mësimit në distancë duhet të bëhet duke u mbështetur në aktivitetet mësimore të zhvilluara, si dhe punën e pavarur në shtëpi të secilit nxënës. Mësuesi/ja, përmes aktiviteteve mësimore që zhvillon me nxënësit e tij/saj dhe përmes vlerësimit të njohurive, aftësive, shkathtësive, vlerave e qëndrimeve, duhet të sigurojë baraspeshë në mes të kërkesave të kurrikulës në arsimin fillor (klasat përkatëse) dhe rrethanave të mësimit dhe vlerësimit në distancë. Kjo nënkupton që mësuesi/ja edhe në këto rrethana duhet t’i angazhojë nxënësit përmes aktiviteteve të ndryshme që e ndihmojnë të vlerësojë përparimin e secilit nxënës në për-

vetësimin e shkrim-leximit themelor, matematikës elementare, njohjes së mjedisit natyror e shoqëror, etj., edhe në kushtet e mësimit në shtëpi.

Rekomandohet që në arsimin fillor (klasat 1-5) të vlerësohet vetëm ajo që është thelbësore për temat dhe njësitë mësimore që zhvillohen gjatë mësimit në distancë, që ndërlidhen me rezultatet e të nxënësve që në fokus kanë komunikimin në gjuhën amtare, leximin, shkrimin dhe llogaritjet me numra, përdorimin e drejtë të simboleve, zgjidhjen e problemeve, të shprehurit kreativ, etj. Mësuesit duhet të bëjnë kujdes të mos i mbingarkojnë nxënësit me detyra të shumta, në mënyrë të veçantë me detyra që nuk mund të kryhen në kushtet e shtëpisë, që nuk mund të kryhen në mënyrë të pavarur nga fëmijët dhe me të cilat nuk mund të vlerësohet puna e pavarur e nxënësve.

Informatat kthyesë duhet të jenë të qarta në formulime për nxënës, me ngjyra që tregojnë saktësinë, apo ndonje lëshim eventual, pozitive, nxitëse, sqaruese, korrigjuese, zhvilluese dhe vlerësuese në raport me detyrat, prezantimet, apo aktivitetet tjera që realizohen gjatë mësimit në distancë.

Secili mësues është i obliguar që të mbajë kontakte direkte me nxënës, përmes prindërve ose kujdestarëve ligjor, ta përcjellë përparimin e nxënësit dhe t'i ofrojë informata kthyesë inkurajuese për përparimin në mësim, mangësitë eventuale, orientimet ku duhet të fokusohet të nxënësit dhe mënyrën si të mësojë, etj. Gjatë mësimit në distancë, informatat kthyesë për nxënësit në arsimin fillor rekomandohet të jenë me gojë dhe me shkrim dhe të ofrohen përmes platformave që mësuesja/i i përdor me nxënësit e tij/saj.

Meqenëse, bazuar në kërkesat e mësimit online secili nxënës duhet t'i dërgojë te mësuesi/ja detyrat me shkrim, ilustrime, skicat dhe punimet tjera, atëherë secili mësues/e duhet t'i ruaj ato në portfolio të nxënësit përkatës për qëllime të vlerësimit. Në kushte të tanishme, portfoliot e tilla duhet të jenë elektronike dhe mësuesi/ja duhet të organizojë skedarë (folderë) të veçantë në kompjuter për secilin nxënës dhe lëndë ku do të ruhen punimet e nxënësve. Pastaj, bazuar në përmbajtjen e portfolios së nxënësit: sasinë, cilësinë, kreativitetin dhe orgjinalitetin e tyre mësuesja/i bën vlerësimin përshkrues për nxënës/in, për klasat 1-2), ndërsa për nxënësit e klasave 3,4,5 bën vlerësimin e tyre me notë.

### 4.3. Vlerësimi në arsimin e mesëm të ulët

Mësimdhënësit e arsimit të mesëm të ulët (klasat 6-9), përmes formave të ndryshme të mësimit në distancë, janë të angazhuar për t'i ndihmuar nxënësit për realizimin e detyrave që janë kërkesë e mësimve orientuese të transmetuara në RTK. Ata, shpjegojnë pjesët e përmbajtjeve, ndajnë me nxënësit materiale të përgatitura, sqarojnë detyrat dhe monitorojnë pjesëmarrjen e nxënësve në mësim. Përveç kësaj, mësimdhënësit duhet të vlerësojnë njohuritë dhe shkathtësitë e nxënësve për plotësimin e kërkesave të kurrikulës, bazuar në kapitullin 3 të këtij udhëzuesi.

Duke marrë parasysh kushtet e nxënësve në shtëpitë e tyre, materialet dhe burimet e tjera të nevojshme për zhvillimin e mësimit në distancë, metodat e vlerësimit duhet të jenë të arsyeshme dhe në interesin më të mirë të nxënësve. Prandaj, është e nevojshme të shmangen metodat e vlerësimit që realizohen me vështirësi apo që mund të

dëmtojnë shëndetin mendor dhe mirëqenien e nxënësve. Me rëndësi është të vlerësohen shkathtësitë e nxënësve për kryerjen e detyrave dhe zgjidhjen e problemeve, e jo njohuritë për përmbajtjet. Në të gjitha lëndët, mësimdhënësit duhet të jenë të kujdesshëm në përzgjedhjen e detyrave dhe aktiviteteve, në mënyrë që ato të jenë stimuluese dhe në të njëjtën kohë në shërbim të sintetizimit të njohurive të tyre. Pritet që fokusi të jetë në detyrat nga matematika, gjuha, shkencat e natyrës dhe ato sociale, por edhe në integrimin mes lëndëve. Secili mësimdhënësi i lëndës/ve mësimore, duke u bazuar edhe në përcjelljen e vazhdueshme paraprake, dhe përcjelljen e tanishme mban shënime për të gjitha metodat dhe teknikat e vlerësimit dhe për veprimtaritë e nxënësve në ditarin personal. Përcaktimi i kriterëve të vlerësimit është pjesë e autonomisë dhe e përgjegjësisë së secilit mësimdhënësi, por në këtë periudhë ato duhet të pasqyrojnë një angazhim minimal të nxënësve.

Gjatë mëimit në distancë përparësi ka vlerësimi i bazuar në metodat inovatore (shih. 3.3.2) të cilat mundësojnë aktivizimin e nxënësve dhe angazhimin e tyre në diskutime gjatë mëimit online, kryerjen e detyrave të shtëpisë, kuizeve, prezantimeve, eseve e testeve, realizimin e detyrave që duhet përfshirë në portfolion individuale, zgjidhjen e problemave, hulumtime apo punën bashkëpunuese gjatë realizimit të projekteve. Për të ndihmuar nxënësit, e sidomos ata që kanë nevojë për më shumë mbështetje, informatat kthyesë për punën e bërë të nxënësve konsiderohet të jetë thelbësore. Është me rëndësi që informatat kthyesë të përqendrohen në atë që duhet të bëjnë nxënësit për të përmirësuar punën e tyre, e jo të jenë gjykuese. Informatat kthyesë duhet të jepen me kohë dhe të jenë pozitive (të fillohen gjithmonë me një koment nga aspekti pozitiv), të jenë të detajuara (të përmbajnë informata dhe sqarime që u ndihmojnë nxënësve për të përmirësuar punën e tyre), realiste (të marrin parasysh mundësitë dhe rrethanat në të cilat mëson nxënësi), dhe të jenë motivuese (përdorimi i fjalëve të përshtatshme dhe inkurajuese është nxitje për të punuar më të mirë në të ardhmen). Sipas nevojës dhe mundësisë, mësimdhënësi/ja mund të regjistrojë një video që u shërben nxënësve për të marrë informata kthyesë dhe komente për ndonjë problem të veçantë ose paqartësi që kanë pasur një numër i madh i tyre.

Për këtë nivel, prindërit, gjithashtu kanë një rol shumë të rëndësishëm. Ata duhet bërë përpjekje për gjetjen e mënyrave për të ndihmuar fëmijët e tyre, duke u angazhuar për sigurimin e mjeteve dhe burime të nevojshme për mësim, duke i frymëzuar dhe inkurajuar ata për të mësuar. Në shumë raste, prindërit mund t'i ndihmojnë fëmijët duke krijuar një lidhje midis asaj që ata po mësojnë dhe përvojave të përditshme në shtëpi. Prandaj, çdo herë që është e mundur, komunikimi dhe bashkëpunimi me prindërit duhet të kontribuoj në vetëdijesimin e nxënësve për marrjen e përgjegjësisë për të nxënë e tyre.

Aktivitetet dhe puna e pavarur e nxënësve duhet inkurajuar dhe vlerësuar pozitivisht nga mësimdhënësit. Kur jepen informatat kthyesë, duhet të merren parasysh nevojat e secilit nxënësi. Disa prej tyre duhet të nxitin për të arritur në një nivel më të lartë dhe të trajtohen me shumë butësi në mënyrë që të mos dekurajohen dhe të mos dëmtohet vetëbesimi i tyre.

### 4.4. Vlerësimi në arsimin e mesëm të lartë

Për dallim nga arsimi parafillor, fillor dhe i mesëm i ulët, ku mësimi në distancë orientohet nga materialet mësimore



të përgatitura nga MASHTI, institucionet e arsimit të mesëm të lartë (klasat 10-12) kanë përgjegjësi të plotë për organizimin e procesit mësimor gjatë kohës së pandemisë. Prandaj, është detyrë dhe përgjegjësi profesionale e secilit mësimdhënës që ta bëjë përzgjedhjen e përmbajtjeve më të rëndësishme, të domosdoshme për arritjen e kompetencave të nxënësve dhe që mund të zhvillohen në kushtet e mësimin në shtëpi, dhe ato të jenë bazë për vlerësimin e arritjeve. Nxënësit angazhohen përmes detyrave të shtëpisë, projekteve e angazhimeve tjera, që ndihmojnë të vlerësohet përparimi i secilit nxënës në rezultatet e të nxënësve dhe arritjen e kompetencave që janë në fokus gjatë mësimin në distancë.

Vlerësimi i arritjeve të nxënësve në arsimin e mesëm të lartë, në rrethanat e pandemisë, duhet shfrytëzuar si një mundësi për të motivuar nxënësit për mësim, për të mbështetur të nxënësve me informata kthyesë për detyrat, projektet e aktivitetet tjera, për të orientuar punën e mëtejme, por edhe për të gjykuar shkallën e pavarësisë dhe arritjes së kompetencave të tyre.

Kompetencat, aftësitë e nxënësve të arsimit të mesëm të lartë për përdorimin e teknologjisë së informacionit si dhe të platformave dhe burimeve të ndryshme dhe punës së pavarur, janë përparësi që duhet shfrytëzuar nga mësimdhënësit e gjimnazeve për të aplikuar qasje të mësimdhënies ndërvepruese që nxisin dhe motivojnë nxënësit të jenë aktivë gjatë gjithë mësimin në distancë. Kjo është edhe njëra ndër kompetencat e Kornizës së Kurrikulës, prandaj detyrë e secilit mësimdhënës është që ta verifikojë dhe ta vlerësojë këtë kompetencë. Kompetenca tjetër e rëndësishme e Kornizës që duhet vlerësuar në këtë nivel të shkollimit është edhe të nxënësve për të nxënë, e cila ka të bëjë me aftësinë e nxënësve për ta vetorganizuar të nxënësve, për të gjetur burimet, për t'i sistemuar njohuritë e fituara dhe për t'i shfaqur ato.

Pavarësisht që akoma nuk ka një vendim përkritazi me mbajtjen e provimit të Maturës Shtetërore dhe mënyrën e realizimit, nxënësit maturantë duhet angazhuar edhe me detyra shtesë nga lëndët për të cilat ata i nënshtrohen provimit të Maturës Shtetërore.

### 4.4.1. Vlerësimi në arsimin profesional

Për lëndët e përgjithshme dhe pjesën teorike të lëndëve profesionale, vlerësimi në kushtet e mësimin në distancë organizohet si edhe për të gjitha shkollat e mesme të larta. Ndërkaq, vlerësimi në lëndët profesionale, ku puna praktike ka një rëndësi të veçantë, kërkon një qasje më specifike. Në kushte të tanishme, organizimi i punës praktike për një numër të konsiderueshëm të profileve është i pamundur. Aty ku nuk ka mundësi të organizohet puna praktike, vlerësimi i nxënësve bëhet duke ju dhënë detyra specifike sipas plan-programit mësimor për të kuptuar nëse nxënësit posedojnë njohuri, shkathtësi dhe kompetencë për të qenë në gjendje t'i zbatojë detyrat edhe në praktikë. Në vend që ti thuhet nxënësit “bëje këtë veprim”, në kushte të tilla, si detyrë do të kërkohet nga ai/ajo të bëjë përshkrimin në detaje të një procesi veprues. Më këtë mësimdhënës do të nxjerrë përfundime, në ç' masë e ka kuptuar nxënësit përmbajtjen, procesin e veprimit dhe, nëse do ta kishte rastin, sa do ishte në gjendje ta zbatonte në praktikë.

**Shembull:** Në mësimin praktik, nxënësi do të kishte për detyrë ta rregullonte një pajisje, e cila nuk funksionon për një arsye të caktuar. Meqë gjatë mësimin në distancë kjo është pothuajse e pamundur, atëherë nxënësve do t'u jepej si detyrë ta bëjnë përshkrimin se si do e bënin rregullimin e asaj pajisjeje, çfarë do të bënin, çfarë mjete pune do të përdornin, çfarë materiali do të ishte i nevojshëm, sa kohë do të duhej për ta rregulluar, etj. Për detyra të caktuara mund të kërkohen skica, vizatime që lidhen me hapat e punës praktike, si në këtë shembull të përshkruar.

Megjithatë, ka raste kur puna praktike mund të realizohet edhe me mjete dhe materiale që janë në dispozicion në shtëpi, për shembull: programimi në kompjuter, puna në firma ushtrimore, dizajni, e të ngjashme. Në raste të tilla, detyrat duhet të jenë të lidhura me praktikën që ka mundësi ta bëjë nxënësi në shtëpi, duke vlerësuar procesin e kryerjes së një detyre praktike, por edhe produktin, për shembull: kodin programor, dokumentacionin e firmës ushtrimore, dizajnin e një objekti të caktuar, etj.

### 4.5. Vlerësimi në lëndët artistike

Megjithëse lëndët nga fusha e arteve nuk trajtohen me përparësi gjatë zhvillimit të mësimit në distancë, përfshirja e nxënësve në këto lëndë ndikon në mirëqenien e tyre, si dhe në zhvillimin e shkathtësive /kompetencave artistike dhe njohjen e koncepteve/dukurive, teknikave dhe proceseve artistike.

Kështu, këndimi dhe luajtja në instrumente, si forma mësimi dhe vlerësimi, mund të realizohen edhe përmes aplikacioneve të zakonshme për komunikim, por edhe me shfrytëzimin e disa aplikacioneve të veçanta për muzikë e incizim. Krijimi artistik muzikor ose pamor mund të demonstron në kohë reale, por edhe të dokumentohet me foto ose video që ruhen në portfolio.

Format tjera, si poster, reflektimi për vepra të caktuara, krijues, performanca, ekspozita, mund të punohen me shkrim nga nxënësit dhe të dorëzohen brenda fatit të caktuar.

Kriteret për vlerësim janë të veçanta për çdo instrument vlerësimi dhe vlejné në përgjithësi kriteret e përgjithshme për komentimin, hulumtimin, prezantimet me shkrim(ese), posterin, si dhe kriteret për vlerësimin e produkteve artistike konkrete (këngë, luajtjen në instrument, vizatimin, pikturën e produktet tjera artistike).

### 4.6. Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta

Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta në kushte normale është një proces kompleks dhe kërkon të përdoren shumëllojshmëri të metodave dhe teknikave të vlerësimit në mënyrë që t'u jepet mundësia të demonstrojnë njohuritë dhe shkathtësitë e tyre. Këtij kompleksiteti i shtohet edhe vështirësia e mësimit në distancë pasi që kërkon edhe shkathtësi digjitale. Për vlerësimin e nxënësve me nevoja të veçanta gjatë mësimit në distancë, duhet të përdorim metoda dhe teknika që funksionojnë dhe përmes të cilave sigurohen informata kthyesë të mjaftueshme për të vlerësuar progresin e nxënësit.

Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta që punojnë me kurrikulë bëhet sipas udhëzimeve që janë dhënë në kapitullin 3 të këtij dokumenti.

Vlerësimi i nxënësve me nevoja të veçanta të cilët punojnë me Plan Individual të Arsimit (PIA) dhe lëndë të individualizuara bëhet me anë të portfolios. Mësimdhënësit, për secilin rezultat mësimor të planifikuar për ta arritur gjatë mësimin në distancë, ofrojnë udhëzime, detyra dhe materiale konkrete për prindër. Puna dhe aktiviteti i nxënësit duhet të dëshmohet nga prindi, ndërsa edukatorja, mësimdhënësi i klasës apo mësimdhënësi lëndor duhet të krijojë portfolion elektronike të secilit nxënës.

Rezultatet e synuara ndahen në hapa të vegjël dhe të thjeshtë që puna e nxënësit të jetë konkrete dhe e matshme. Për secilin hap të punës që synon arritjen e rezultatit individual duhet të jene të paktën dy dëshmi të punës së nxënësit p.sh: foto, video, etj. Mësimdhënësit gjithashtu duhet të mbajnë listën e kontrollit të detyrave që siguron mbarëvajtjen e përfundimit të aktiviteteve/detyrave të nxënësit në kohën e caktuar.

Për fëmijët/nxënësit në Qendra Burimore dhe në institucione parashkollore të cilët përdorin Programin me fusha të aktiviteteve (niveli parafillor) vlerësimi bëhet sipas udhëzimeve të programit dhe përdoren 3 formularë.

**Formulari 1** Shënohen informatat për zbrëthimin e aftësive në hapa, plotësohet nga mësuesi, /prindi/kujdestari e rikthen formularin e plotësuar të mësuesi/ja dhe vazhdimisht këshillohet në procesin e realizimit të aftësive. Në rast që për shkaqe objektive nuk mund të kthehet formulari i plotësuar, atëherë kjo dëshmohet përmes fotove, video-incizimeve apo edhe në bazë të konsultimit/bisedës me telefon.

**Formulari 2** Shërben për evidentimin e të dhënave për zhvillimin i shkathtësive për secilin fëmijë. Mësuesja nga Formulari 1 përcjell të dhënat në Formularin 2 të cilin e miraton mësuesi/sja, drejtori i shkollës dhe në fund të muajit e dorëzon një kopje të prindërit.

**Formulari 3** Shërben për evidentimin e arritjeve në gjysmëvjetor dhe në fund të vitit shkollor për secilin fëmijë.

Vlerësimi i nxënësve të verbër, me dëmtime në të parë dhe nxënësit me dëmtime në dëgjim, parimisht është i njëjtë si i gjithë nxënësve tjerë. Nxënësit me dëmtime në të parë përdorin pajisjet teknologjike dhe komunikojnë online me tekst, me zë apo me video. Në këtë kuptim në pjesën më të madhe opsionet e vlerësimit në distancë që janë dhënë në kapitullin 3 mund të përdoren për këto dy kategori të nxënësve.

Për nxënësit e verbër mund të përdoren edhe forma specifike të vlerësimit si: pyetje përgjigje me zë; detyrat me shkrim; testet dhe kuize të shkurtra ditore apo përmbledhëse të udhëhequra nga mësimdhënësi; ese, punime artistike; portfolio.

Në procesin e vlerësimit në distancë të fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta është e rëndësishme që mësimdhënësit, prindërit/kujdestaret të ndërtojnë marrëdhënie pozitive, t'i motivojnë dhe inkurajojnë përpjekjet e fëmijës, të vëzhgojnë angazhimin dhe punën, të japin informata, udhëzime të qarta, të shkurtra dhe t'u japin kohë më tepër pasi që për fëmijët me nevojat të veçanta kjo është thelbësore.

## 5. Roli i prindërve

Duke pasur parasysh gjendjen e jashtëzakonshme, prindërit duhet të përfshihen më shumë se kurrë në punën e shkollës, por edhe në sigurimin e një rrethi të besimit për të mësuar, dhe kjo është veçanërisht e nevojshme për nxënësit e shkollës fillore. Para së gjithash, të gjithë ne duhet ta kemi prioritet mirëqenien e nxënësve të cilët duhet t'i inkurajojmë të mësojnë përmes angazhimeve cilësore, detyrave dhe aktiviteteve mësimore. Duke pasur parasysh që situata e krijuar është e re për ne, edhe forma e mësimi që po ofrohet është gjithashtu e re. Prandaj, është shumë me rëndësi që të gjithë ne - mësimmshënës, nxënës dhe prindër - ta mirëkuptojmë dhe të përkrahim njëri-tjetrin.

Gjatë mësimi në distancë, prindërit duhet të jenë shumë më të angazhuar me fëmijë sesa gjatë mësimi të rregullt në shkollë.

Megjithëse është e vështirë, duke marrë parasysh rrethanat, nga prindërit pritet të bëjnë më shumë tani kur organizohet mësimi në distancë sesa kur organizohet në shkollë. Prindërit tani e kanë mundësinë ta shohin dhe ta përcjellin procesin mësimor më mirë se sa kur mësimi zhvillohet në shkollë, si dhe të shohin se mënyrat e ndryshme të vlerësimit të nxënësve – fëmijëve të tyre.

Prindërit duhet të vendosin disa rregulla të shkollës në shtëpi për fëmijët e tyre duke caktuar kohë për të mësuar (veçanërisht për fëmijët në shkollën fillore). As fëmijët dhe as prindërit nuk e perceptojnë shtëpinë e tyre si shkollë pasi që janë mësuar se vetëm detyrat e shtëpisë bëhen në shtëpi. Ky perceptim nuk vlen në këto rrethana, dhe kjo duhet të kuptohet qartë nga prindërit dhe fëmijët.

Prindërit duhet të vendosin disa rregulla në shtëpi, duke caktuar kohën kur fëmijët mësojnë.

Roli i prindërve është të inkurajojnë fëmijët për të kryer të gjitha detyrat në mënyrë të pavarur dhe që të këshillohen me mësimmshënësit e vet gjatë orëve virtuale në nivel të shkollës për çdo paqartësi. Është përgjegjësia e prindit për të përkrahur fëmijën – gjithsesi jo duke kryer detyrat në vend të fëmijës. Është e kuptueshme dëshira e prindërve për performancë të mirë të fëmijëve në shkollë. Mirëpo, përkrahja e prindërve nuk duhet të marrë formën e të shkruarit/kryerjes së detyrave në vend të fëmijëve e as të ushtrimit të presionit tek fëmijët apo mësuesit lidhur me kryerjen e detyrave apo vlerësimin e detyrave nga mësimmshënësit. Prindërit të cilët marrin përgjegjësi dhe obligime të cilat nuk i kanë, ndikojnë në dëmtimin e zhvillimit të përgjegjësisë dhe pavarësisë tek fëmijët si dhe zvogëlojnë gjasat e tyre për të qenë të pavarur në procesin e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe zgjidhjen e problemeve në jetë.

Mësimi në distancë i transmetuar në RTK dhe në YouTube është forma kryesore orientuese për zhvillimin e mësimi dhe plotësimin e kërkesave të kurrikulës shtetërore për klasat 1-9. Mësimmshënësit angazhohen në punë me nxënësit për t'i ndihmuar ata në plotësimin e kërkesave të mësimi në distancë që transmetohet në RTK (shpjegimi i pjesëve të përmbajtjes, sqarimi i detyrave, monitorimi i detyrave të shtëpisë, monitorimi i pjesëmarrjes në mësim, plotësimi i portfolios, mbajtja e ditarit të të nxënësve të tjerë).

Mësimi në distancë në nivel të shkollave të mesme të larta (gjimnaze dhe shkolla profesionale) zhvillohet në bazë të planit, organizimit dhe formave të punës të përcaktuara në nivel shkolle dhe në përputhje me udhëzuesit e MASHTI. Prandaj, prindërit duhet të bashkëpunojnë me mësimdhënësit për të siguruar mirëqenien e përgjithshme të fëmijëve të tyre, t'i inkurajojnë ata të mësojnë, të hulumtojnë dhe të organizojnë kohën e tyre sa më mirë gjatë mësimit në këto kushte të jashtëzakonshme.

Gjatë mësimit dhe vlerësimit, prindërit duhet të monitorojnë punën e fëmijëve dhe, në bashkëpunim me mësimdhënësit, t'i ndihmojë ata për të gjetur mënyrën më të mirë për të mësuar në këto kushte.

Ky udhëzues nuk është përgatitur të studiohet e analizohet në tërësi nga prindërit, por është mirë që prindërit të familjarizohen me udhëzimet kryesore dhe pritshmëritë për nxënësit në nivele të ndryshme të arsimit.

Lidhur me vlerësimin e fëmijëve, udhëzimet e mëposhtme janë të rëndësishme për prindërit.

- Prioritet është mirëqenia e fëmijëve duke ju dhënë informata kthyes cilësore të cilat ndikojnë dhe inkurajojnë fëmijët për të mësuar më shumë.
- Mësimdhënësit do të vlerësojnë punën dhe angazhimin e nxënësve bazuar në: pjesëmarrjen në takimet virtuale, punën e pavarur, kreativitetin e treguar, aftësitë për të përdorur njohuritë e tyre në zgjidhje të problemeve, kontributin dhe punën në ekip me fëmijët tjerë, etj.
- Vlerësimet përmbledhëse me notë do të bëhen në përputhje me vendimet përkatëse të MASHTI dhe DKA. Ky udhëzues përcakton format e vlerësimit në këtë fazë të zhvillimit të mësimit në distancë.
- Disa detyra mund të jenë komplekse, dhe pritet që fëmijët të punojnë në mënyrë të pavarur në zgjidhjen e tyre. Prindërit është mirë të njihen me këto detyra komplekse, por jo të marrin mbi vete zgjidhjen e tyre duke i 'bërë detyrat' në vend të fëmijëve të tyre.
- Sa herë që është e mundur, prindërit do t'u japin fëmijëve përgjigje/mendim nëse ata/ato i kanë arritur rezultatet e parapara, por edhe komente e sugjerime se si mund t'i përmirësojnë ato rezultate. Për ta arritur këtë, prindërit duhet ta monitorojnë punën e fëmijëve dhe të inkurajojnë aktivitetin dhe bashkëpunimin e tyre, si me mësimdhënësit ashtu edhe me nxënësit e tjerë. Ndhima e prindërve është shumë e rëndësishme në këtë kontekst.
- Përmbajtjet dhe temat mësimore që mësimdhënësit ua japin nxënësve, zakonisht përqendrohen në elementet më të rëndësishme lidhur me temën a njësinë mësimore. Në këto kushte mësimi e pune, fëmijët do të udhëzohen të mësojnë/studiojnë pjesët esenciale lidhur me temën/njësinë mësimore dhe jo çdo detaj ose faktet lidhur me të.
- Është me rëndësi të kuptohet se të gjitha metodat e vlerësimit do të orientohen në vlerësimin e nivelit të arritjes së pritjeve lidhur me përmbajtjet themelore, e jo vlerësim të detajeve a fakteve të ndryshme.

Udhëzimet specifike për format e vlerësimit të fëmijëve, metodat dhe instrumentet i gjeni në kapitujt 3 dhe 4 të këtij udhëzuesi.

